

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7870
E martë, 27 gusht 2024
Çmimi 0.50

Rama thotë se më
2027 Shqipëria do të jetë
mikpritëse e samitit
të NATO-s I FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRELEC: HAPJA E URËS SË IBRIT, SI AKT SIMBOLIK, PA MBËSHTETJEN E PERËNDIMIT MUND TË NXISË TENSIONE

 I FAQE 4-5

Eksperti për Ballkanin në Grupin
Ndërkombëtar të Krizave, Marko
Prelec, beson se hapja e urës
kryesore mbi Ibër në Mitrovicë pa

mbështetjen e perëndimit, mund
të nxisë tensione të reja në veriun
e Kosovës. Prelec thotë se kjo
çështje vlen të trajtohet në dialog,

të paktën si një gjest miqësor
ndaj Bashkimit Evropian për
mbështetjen që i ka dhënë
Kosovës

**INFORMACIONET E RREME
DËMTOJNË INSTITUCIONET,
VENDIT I DUHET NJË
MEKANIZËM PËR
VERIFIKIMIN E LAJMEVE** F. 3



**RRITJA E RASTEVE ME
COVID-19, NUK ËSHTË
SHQETËSUESE** F. 3



AKTUALE



**SCHOLZ MBËSHTET DËBIMIN E
MIGRANTËVE TË JASHTËLIGJSHËM**

F. 2

**S'LEJOHEN MË NË OBORRIN
E QKUK-SË AMBULANCAT
E SPITALEVE PRIVATE, AUTOMJETET
PËR BARTJEN E KUFOMAVE
DHE TAKSITË** F. 7

**KURTI TAKON PJESËMARRËSIT E
SEMINARIT TË 42-TË
NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN,
LETËRSINË DHE KULTURËN
SHQIPTARE** F. 6

EKONOMI



**FORUMI EKONOMIK I GRAVE I
REAGON QEVERISË PËR HEQJEN E
LIGJIT PËR PUNËN NGA KALENDARI
LEGJISLATIV** F. 8

**KRASNIQI: MARRËVESHJET
NDËRKOMBËTARE DËMTOJNË
BIZNESET, NEVOJITET
RINEGOCIIM I MENJËHERSHËM** F. 8

SPORT

**AKINBULE PASI FITOI ÇMIMIN
"YLLI I JAVËS" NË SUPERLIGË:
SYNOJMË TITULLIN** F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shagiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Irani thotë se Izraeli ka “humbur fuqinë parandaluese”

TEHRAN, 26 GUSHT - Izraeli raportohet se ka kryer sulme të reja ajrore ndaj Hezbollahut, grupit libanez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara brenda Libanit, një ditë pasi palët këmbyen sulme me raketa e dronë. Irani tha se sulmet e Hezbollahut ndaj Izraelit tregojnë ndryshim të balancës së fuqisë.

Mediat shtetërore raportuan më 26 gusht se Izraeli ka shënjestruar fshatin kufitar të Tair Harafit dhe një zonë afër Sidonit në Liban, një ditë pas Hezbollahu gjuajti dhjetëra raketa dhe dronë kundër caqeve në Izraelin verior dhe qendror. Kjo valë sulmesh u krye pak pasi Izraeli kreu atë që i cilësoi si sulme parandaluese ndaj raketahedhësve të Hezbollahut.

Ende nuk ka raportime për viktima nga sulmet e Izraelit të kryera më 26 gusht.

Irani tha më 26 gusht se këmbimi i zjarrit që është një prej përplasjeve më të mëdha në

Lindjen e Mesme që kur nisi lufta në Gazë tetorin e vitit të kaluar - tregoi se Izraeli nuk ka humbur vetëm aftësinë e tij për të parashikuar sulme në shkallë të vogël, por po ashtu edhe fuqinë parandaluese.

“Pavarësisht mbështetjes, përfshirë të ShBA-së, Izraeli ka humbur fuqinë parandaluese dhe aftësinë për të parashikuar kohën dhe vendimin e sulmeve të kufizuara dhe precize”, shkroi në X zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme të Iranit, Nasser Kanani, duke iu referuar sulmit të një ditë më parë në shkallë të gjerë të kryer ndaj Izraelit nga Hizbollahu, aleati libanez i Iranit. “Regjimi pushtues gjithmonë ka kërkuar zgjerim territorial, por tani duhet ta mbrojë veten brenda territoreve të pushtuara. Frika është mbjellë në mesin e banorëve që jetojnë në tokat e pushtuara”, shtoi Kanani.

Zyrtarët izraelitë kanë thënë se sulmet parandaluese penguan lëshimin e “mijëra” raketave të



tjera. Hezbollahu ka pretenduar se ka gjuajtur mbi 320 raketa dhe dronë, por Izraeli ka thënë se ky numër është rreth 150.

Lideri i Hezbollahut, Hassan

Nasrallah, pretendoi se operacioni i grupit ishte i kalibruar, për të siguruar që të mos nxitet një konflikt i shkallës së plotë.

Duke iu adresuar Nasrallahut dhe liderit suprem të Iranit, Ajatollah Ali Khamenei, kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, tha se operacioni parandalues i Izraelit “ishte një hap tjetër drejt ndryshimit të situatës në veri dhe kthimit të sigurt në shtëpi të banorëve”.

Hezbollahu tha se operacioni ishte “faza e parë” e hakmarrjes së grupit për vrasjen e Fuad Shukur, që besohet se ishte numri dy më i fuqishëm i grupit. Shukur u vra gjatë një sulmi izraelit në Bejrut më 30 korrik.

Disa orë pas vrasjes së tij, në Teheran u vra shefi politik i Hamasit, grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian. Irani është zotuar se do të hakmerret për vrasjen e Ismail Haniyehut dhe e ka akuzuar Izraelin se qëndron prapa vrasjes. Izraeli nuk e ka mohuar e as marrë përgjegjësinë për vrasjen e shefit politik të Hamasit.

ShBA-ja dhe Seuli në ushtrime të përbashkëta, Koreja e Veriut teston dronët

UASHINGTON, 26 GUSHT - Lideri i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, mbikëqyri një demonstrim të dronëve të rinj shpërthyes të dizajnuar për të goditur objektiva, njoftoi media shtetërore të hënën, ndërsa ShBA-ja dhe Koreja e Jugut janë duke kryer stërvitje të përbashkëta ushtarake.

Fotografitë e testimit nga Koreja e Veriut shfaqën një dron të bardhë në formë të shkronjës ‘X’ që supozohet se po godiste dhe shkatërronte një objektiv që ngjasonte me tankun kryesor të Koresë së Jugut, K-2.

Shumica e dronëve luftarakë qëndrojnë larg objektivave dhe lëshojnë raketa.

Agjencia Qendrore e Lajmeve e Koresë së Veriut (KCNA) tha se testimi i së shtunës përfshinte lloje të ndryshme të dronëve të ndërtuar për të fluturuar në



distanca të ndryshme për të sulmuar objektivat e armikut në tokë dhe det, duke fluturuar përgjatë rrugëve të ndryshme para se të godisnin saktësisht

objektivat, raporton AP.

Pas testimit, Kim u zotua të përshpejtojë zhvillimin e dronëve që shpërthejnë kur përplasen, kryejnë zbulime ose sulmojnë

objektiva nën ujë për të përmirësuar gatishmërinë luftarake të vendit të tij, duke thënë se ushtria e Koresë së Veriut duhet të pajiset me dronë të avancuar “sa më herët që të jetë e mundur”, raportoi media shtetërore.

Testimi i dronëve u bë në kohën që ushtria e ShBA-së dhe ajo e Koresë së Jugut po kryejnë një stërvitje masive, e cila do të vazhdojë deri të enjten.

Stërvitjet përqendrohen në përmirësimin e gatishmërisë kundër kërcënimeve nga Koreja e Veriut dhe përfshijnë simulime kompjuterike të luftës dhe trajnim me armë zjarri, me një stërvitje të përbashkët ajrore që përfshin 60 avionë luftarakë.

Forcat ajrore të Koresë së Jugut thanë se stërvitja, e cila filloi me demonstrime të bombardimeve

precize që përfshinin avionët luftarakë F-35 dhe F-16 të Koresë së Jugut, ka për qëllim përbashkëtimin e kërcënimeve nga dronët, raketat lundruese dhe nga artileria e Koresë së Veriut.

Zëdhënësi i Shefave të Shtabit të Përbashkët të Koresë së Jugut, Lee Chang Hyun, tha se ushtria e Koresë së Jugut po shqyrtonte me kujdes aftësitë e dronëve të Koresë së Veriut dhe se ushtria e Koresë së Jugut është e pajisur me sisteme për t'i zbuluar dhe kapur ato, pa dhënë detaje të mëtejshme.

Disa analistë sugjerojnë se dronët e Koresë së Veriut të treguar në fotografitë e medias shtetërore ngjajnë me dronët Zala Lancet-3 të Rusisë, dhe Lee tha se Koreja e Jugut po shqyrtonte mundësinë që Rusia të ketë ndihmuar Korenë e Veriut të aftësohet në fushën e dronëve.

Scholz mbështet dëbimin e migrantëve të jashtëligjshëm

BERLIN, 26 GUSHT - Kancelari gjerman, Olaf Scholz, tha të hënën se dëshiron të rrisë dëbimet e migrantëve të jashtëligjshëm, disa ditë pas një sulmi me thikë në qytetin perëndimor të Solingenit. “Dëbimet duhet të përshpejtohen, me rregullore ligjore nëse është e nevojshme”, tha Scholz gjatë

një vizite në Solingen.

Kancelari gjithashtu kërkoj “zbatimin e qëndrueshëm dhe praktik” të ligjeve ekzistuese, përfshirë ato për migrantët që aplikojnë për azil në Gjermani dhe jo në vendin e parë të Bashkimi Evropian ku ata mbërrijnë në kundërshtim me Rregulloren e Dublinit. “Me siguri do të

ketë kuptim të krijohet një grup i posaçëm për të studiuar këtë”, shtoi kancelari Scholz.

Tre njerëz u vranë dhe tetë të tjerë u plagosën në sulmin e së premtes së kaluar në një shesh në qendrën e qytetit të Solingenit.

I dyshuari 26-vjeç, i cili është me origjinë nga Siria, u

dërgua në paraburgim me urdhër të gjykatës, raporton agjencia gjermane DPA.

Sulmuesi, i cili dyshohet se është anëtar i grupit terrorist të Shtetit Islamik, raportohet se ishte parashikuar të dëbohej në Bullgari pas mbërritjes në Gjermani në vitin 2022, por policia nuk arriti ta lokalizonte atë.



Rama thotë se më 2027 Shqipëria do të jetë mikpritëse e samitit të NATO-s

TIRANË, 26 GUSHT - Kryeministri shqiptar, Edi Rama, tha të hënën se në vitin 2027 Shqipëria do të mirëpresë samitin e NATO-s. Këto komente Rama i bëri gjatë konferencës së ambasadorëve, që po mbahet në Tiranë.

Rama tha para ambasadorëve se diplomacia shqiptare tashmë ka hyrë në një dinamikë të re. "Vitin e ardhshëm do të jemi vendi që do të mirëpresë liderët e 44 shteteve evropiane - nga Britania e Madhe në Ukrainë apo nga Suedia, Norvegjia deri në Turqi - në samitin e Komunitetit Politik Evropian. Më 2027 do të kemi mundësinë të jemi mikpritës të samitit të NATO-s. Gjëra që as nuk mund të imagjinoreshin vite më parë - që Shqipëria të bëhej një pikë referimi e t'i besoheshin të tilla role", deklaroi Rama.

Radio Evropa e Lirë kërkoi komente nga NATO-ja në lidhje me njoftimin e Ramës, por nuk mori përgjigje.

Samiti i sivjetmë i NATO-s është mbajtur nga 9 deri më 11 korrik në Uashington.

Kryeministri Rama tha se objektivi i Qeverisë që drejton është që më 2030, Shqipëria duhet të jetë gati për t'u ulur në tryezën e BE-së. Ai

theksoi se "për këtë rol i ambasadorëve është tepër i rëndësishëm dhe duhet të ngrihet në një nivel të ri".

Sa i përket marrëdhënieve të Shqipërisë me vendet e rajonit, Rama tha se është bërë i qartë vizioni i Qeverisë që drejton për të parë drejt së ardhmes dhe për të mos u kthyer te problemet e së shkuarës. "Leximi i së ardhmes me sytë e së shkuarës nuk na takon. Kjo është qasja e pika kyç, mbi të cilat ngremë marrëdhëniet e ndërveprimet me rajonin. Duhet të bëjmë më shumë me Italinë, Turqinë e Greqinë. Së shpejti duhet t'i çelim dyert e Ambasadës në Bosnje Hercegovinë", tha kryeministri Rama.

Në lidhje me marrëdhëniet me Kosovën, Rama tha se është detyrë e Shqipërisë për ta mbështetur "formësimin përfundimtar të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës".

Kreu i Qeverisë shqiptare kërkoi nga ambasadorët t'i kushtojnë më shumë vëmendje diplomacisë ekonomike. Për këtë ai kërkoi që marrëdhëniet tregtare dhe të biznesit të mos përqendrohen vetëm te vendet e Bashkimit



Evropian, por të zgjerohen edhe me Emiratet e Bashkuara, Arabinë Saudite, Azerbajxhanin, Kuvajtin, etj.

Në lidhje me dy shtetet e tjera, Indonezinë dhe Filipinet, kryeministri Rama tha se të gjitha vendet e BE-së janë në kërkim të

fuqisë punëtore, ndaj edhe Shqipëria do të bëjë të njëjtën gjë. Konferenca tre ditore "Tirana Diplo 2024" po zhvillohet në kohën kur Qeveria shqiptare po përgatit ndryshime në ligjin për shërbimin e jashtëm. Ministri i Punëve të Jashtme, Igli Hasani, tha

se ndryshimet janë në përputhje me sfidat e diplomacisë shqiptare. Në konferencë marrin pjesë ambasadorë dhe konsuj të Shqipërisë në botë. E pranishme është edhe zëvendëskryeministrja e Sllovenisë, Tanja Fajon, gjithashtu ministre e Jashtme.

Informacionet e rreme dëmtojnë institucionet, vendit i duhet një mekanizëm për verifikimin e lajmeve

PRISHTINË, 26 GUSH T- Informacionet e rreme prishin reputacionin e institucioneve në vend, por edhe më shumë dëmtojnë personat të cilët janë subjekt i lajmit, andaj është i nevojshëm krijimi i një institucioni për verifikimin e lajmeve.

Kështu u tha në diskutimin e organizuar nga Demokraci për Zhvillim (D4D), me temën "Sigurimi i integritetit: Verifikimi i fakteve në Sistemin e Drejtësisë në një epokë të keqinformimit mediatik".

Aty u tha se keqinformimi është rritur më shumë në rrjetet e ndryshme sociale, ndërsa u kërkua që të merren shembull shtetet e rajonit që kanë mekanizëm për verifikimin e lajmeve.

Marcel Lekaj nga Zyra për Informim dhe Komunikim në Gjykatën Themelore në Prizren, ka thënë se gjykatat marrin gjithnjë e më shumë rol aktiv në transmetimin e informacionit te publiku.

Dhe për këtë, ai shtoi se publiku duhet të informohet drejtë dhe të mos keq dezinformim. "Besoj që të gjithë kemi një dëshirë dhe qëllim të përbashkët, që është ofrimi i shërbimeve cilësore për qytetarët dhe palët që marrin

shërbime në gjykata, dhe mbrojtja e proceseve gjyqësore dhe palëve të përfshira në këto procese. Për gjyqësorin është e rëndësishme që publiku të informohet saktë dhe me kohë për zhvillimet në sistemin e drejtësisë. Gjykatat marrin gjithnjë e më shumë rol aktiv në transmetimin e informacionit te publiku", ka thënë ai, duke shtuar se keqinformimi apo dezinformimi tashmë me përdorimin e platformave të ndryshme sociale, është e lehtësuar shumë, ndoshta edhe për shkak të mungesës së kontrollit dhe rregulloreve për funksionimin e mediave online, portaleve të shkruara dhe platformave të ndryshme. "Aktualisht ka një interesim të madh të mediave, për raportime nga Gjykata, sidomos për proceset gjyqësore që janë në zhvillim, dhe kjo rrit sfidën për gjykata që të monitorojnë lajmet dhe informacionet që përhapen. Realisht mungon teknologjia apo mekanizmat, për raportimin në platforma online, të dezinformatave, sidomos në kohë të shpejte ashtu që dezinformata mos të prodhon efekt tek publiku", u shpreh Lekaj. Sipas tij, përhapja e



informacioneve të rreme, dëmton jashtëzakonisht reputacionin e institucioneve, por edhe më shumë dëmton personat të cilët janë subjekt i lajmit. "Verifikimi i fakteve kur raportohet nga procese gjyqësore, apo procese që zhvillohen ndaj palëve në institucione të drejtësisë siç janë Policia dhe Prokuroria, sot paraqet sfidë në vete edhe për vetë gazetaret dhe

mediat, sepse shpejtësia me të cilin qarkullon shkrimet apo lajmet është e jashtëzakonshme. Përhapja e informacioneve të rreme, dëmton jashtëzakonisht reputacionin e institucioneve, por edhe më shumë dëmton personat të cilët janë subjekt i lajmit", shtoi ai. Avokatja, Valdita Shkukriu ka deklaruar se keqinformimi është sfidë globale dhe duhet të krijohet

një institucion për verifikimin e lajmeve që qytetarët të informohen drejtë. Ndërsa gazetari, Fisnik Minci ka theksuar se duhet të dallohet se çka është thashetheme, spekulim dhe e vërtetë. Minci ka thënë se nuk është nevoja për ligjin e ri të KPM-së, pasi sipas tij, duhet përdorur metoda si në vendet perëndimore që është procesi vetërregullues.



Prelec: Hapja e urës së Ibrit, si akt simbolik, pa mbështetjen e perëndimit mund të nxisë tensione

Eksperti për Ballkanin në Grupin Ndërkombëtar të Krizave, Marko Prelec, beson se hapja e urës kryesore mbi Ibër në Mitrovicë pa mbështetjen e perëndimit, mund të nxisë tensione të reja në veriun e Kosovës. Prelec thotë se kjo çështje vlen të trajtohet në dialog, të paktën si një gjest miqësor ndaj Bashkimit Evropian për mbështetjen që i ka dhënë Kosovës

PRISHTINË, 26 GUSHT- Eksperti për Ballkanin në Grupin Ndërkombëtar të Krizave, Marko Prelec, tha se hapja e urës kryesore mbi Ibër, si një akt simbolik, pa mbështetjen e perëndimit mund të nxisë tensione të reja në veriun e Kosovës. Prelec tha se shmangia e tensioneve të reja në Kosovë, mund të ketë qenë një nga temat e diskutimeve të Drejtorit të Agjencisë Qendrore amerikane të Zbulimit (CIA), William Burns, gjatë takimeve me udhëheqësit e Kosovës. Ai beson se vizita e Burnsit, i cili qëndroi në Kosovë pas vizitave në Bosnjë dhe Serbi, synonte “të çojë përpara disa interesa amerikane rreth qëndrueshmërisë së rajonit”. Vizita përkoi me një kohë kur qeveria amerikane po kundërshtonte vendimet për

veriun e Kosovës të qeverisë së kryeministrit Albin Kurti, përfshirë synimet për hapjen e urës që ndan dy komunat e qytetit - jugun më shumicë shqiptare dhe veriun me shumicë serbe. Prelec tha se hapja e urës, më shumë se gjithçka tjetër, është një akt simbolik. “Janë tri ura në qytet, dy prej të cilave janë të hapura për trafikun e makinave, ndërkaq ura kryesore, është dhe ka qenë, për sa kohë mbaj mend e hapur për këmbësorë dhe përdoret gjerësisht. Unë vet e kam kaluar shumë herë. Mund të shihni njerëz që shkojnë nga veriu në jug për blerje, nga jugu në veri për takime, kështu që kjo nuk është si shembja e murit të Berlinit, është një akt simbolik sepse është në qendër dhe sepse menjëherë pas ndërhyrjes së NATO-s në vitin 1999 kjo urë ishte epiqendra ku prania

paraushtarake serbe në veri u përpoq të ndalojë shqiptarët e armatosur ta kalonin urën, pra ishin aty të ashtuquajturit rojet e urës”, tha ai.

Shtetet e Bashkuara, NATO-ja dhe Bashkimi Evropian kërkojnë zgjidhjen e kësaj çështjeje në kuadër të dialogut në Bruksel.

Prelec, thotë se kjo çështje ia vlen të trajtohet në dialog, të paktën si një gjest miqësor ndaj Bashkimit Evropian për mbështetjen që i ka dhënë Kosovës. “Mendoj se ka një kohë që dialogu është në një lloj kome dhe kjo ka të bëjë me synimin e tij thelbësor, që t’i shtyjë palët drejt normalizimit në një mënyrë gjithëpërfshirëse. Qartazi që kjo nuk po ndodhë dhe nuk duket të ketë shumë perspektivë në ringjalljen e atij dialogu politik drejt normalizimit në të ardhmen e afërt, të paktën jo këtë vit. Por, ajo që dialogu mund të bëjë është të trajtojë çështje të nivelit më të ulët si çështja se çfarë të bëhet me urën kryesore në Mitrovicë”, thotë Prelec.

Ai beson se hapja e urës pa bashkërendim ndërkombëtar mund të nxisë tensione të reja. “Por nuk pres domosdoshmërisht të ketë ndonjë lloj dhune, mund të

shohim demonstrata. Përshtypja ime, duke theksuar se kanë kaluar disa muaj prej që kam vizituar Kosovën dhe gjërat mund të kenë ndryshuar, por nga hera e fundit që kam qenë në veri përshtypja ime është se popullata atje është mjaft e frikësuar dhe se nuk ndihet sikur është në pozicion të kryej akte që tregojnë forcën siç është provuar në të kaluarën me vendosjen e barrikadave apo individ të caktuar që kryenin veprime, që disa do t’i cilësonin si paraushtarake, e të tjerë si terrorizëm kundër shtetit. Nuk duket të ketë gatishmëri tani për tani në veri të Kosovës për të bërë diçka të tillë”, tha ai.

Shtetet e Bashkuara kanë theksuar se mungesa e bashkërendimit të qeverisë së Kosovës rreth veprimeve në veri tashmë ka dëmtuar partneritetin ndërmjet dy qeverive. Bashkimi Evropian ka paralajmëruar mundësinë e shtimit të masave ndëshkuese për Kosovën.

Prelec tha se pohimi i kritikëve se qeveria po “vë në rrezik aleancat”, mbase është një qëndrim tepër i fortë, por sipas tij, është shumë e qartë për një grup të gjerë të vëzhguesve se qeveria e Kosovës tashmë ka dëmtuar marrëdhëniet me aleatët e saj më të rëndësishëm

në një shkallë domethënëse.

“Shtetet e Bashkuara ndoshta janë më të zëshme se të tjerët por edhe Bashkimi Evropian dhe vende të ndryshme anëtare si Franca, Gjermania, Italia kanë qenë mjaft të qarta rreth dëmit që u është shkaktuar marrëdhënieve dhe faktit se janë më pak të gatshëm të ndërhyjnë në emër të Kosovës. Kështu që kjo tashmë ka ndodhur. Nuk shoh shumë mundësi për përshkallëzim të mëtejshëm sepse në veri të Kosovës mendoj që qeveria i ka arritur synimet e saj. Ka përmbushur këto synime në kuptim të ndërmarrjes së hapave të rëndësishëm për të larguar institucionet serbe dhe për vendosjen e autoritetit të saj dhe tërësisë tokësore. E ka paguar një çmim për këtë dhe tani kjo është e kryer”, tha Prelec.

Në një intervistë me “Zërin e Amerikës” në fillim kësaj jave, kryeministri i Kosovës Albin Kurti, duke folur lidhur me përplasjet me Perëndimin dhe kritikën e opozitës për mungesë bashkërendimi me aleatët për shumë çështje, tha se dallimet në qëndrime nuk kanë qenë asnjëherë në qëllime, vlera e parime, por vetëm në strategji, taktika dhe operacione.

Të huajt, të domosdoshëm për ekonominë gjermanolindore

BERLIN, 26 GUSHT- Sipas një studimi të ri, të huajt janë një shtyllë e rëndësishme e ekonomisë në Gjermaninë Lindore. 403.000 vetë që jetojnë atje pa pasaportë gjermane gjeneruan 24.6 miliardë euro vitin e kaluar, sipas Institutit të Ekonomisë Gjermane (IW) në Këln, institut i afërt me biznesin. Kjo korrespondon me 5.8% të vlerës së shtuar bruto të pesë lendeve të Gjermanisë Lindore. Po të merret parasysh edhe ndërvarësia brenda ekonomisë, shifra do të arrinte madje 6.9%. Në pesë vitet e fundit, polakët dhe çekët kanë qenë të ardhurit kryesorë në Lindje të Gjermanisë, si dhe shumë rumunë dhe ukrainas. Ata punojnë kryesisht në ndërtim, por edhe në sektorin e transportit dhe përmes agjencive të punësimit të përkohshëm në

Gjermani, sipas IW. Në të njëjtën kohë, ndryshimi demografik në tregun e punës në landet Brandenburg, Mecklenburg-Vorpommern, Saksoni, Saksoni-Anhalt dhe Turingi po ndihet shumë më fuqishëm se në pjesën tjetër të vendit: sipas studimit, numri i punonjësve gjermanë. Në këto rajone u ul me 116.000 në periudhën 2018-2023, ndërkohë që pati një rritje prej 200.00 vitesh në të gjithë Gjermaninë. Autori i studimit, Wido Geis-Thöne, konkludon: “Punonjësit e huaj janë të domosdoshëm për Lindjen”. “Është edhe më e rëndësishme që rajoni të mbetet kozmopolit, sepse vetëm atëherë Lindja do të vazhdojë të jetë e suksesshme ekonomikisht”, thotë Geis-Thöne.

Pa ardhjen e të huajve të rinj, ekonomia do të ishte ulur ndjeshëm. Në vend të kësaj, ajo është rritur. “Saksonia përfiton veçanërisht nga kjo”, vazhdon studimi i IW. Të huajt gjeneruan rreth 7.9 miliardë euro atje. Brandenburg, me një ekonomi të përgjithshme dukshëm më të vogël, regjistroi 6.8 miliardë euro dhe Turingia ende 3.9 miliardë euro. Parlamente të reja do të zgjidhen në secilin prej këtyre tre lendeve federale në shtator. Sipas sondazheve, partia AfD - e kategorizuar si e djathtë ekstreme në disa zona - mund të presë një rritje të fortë. “Gjermania Lindore nuk ka reputacionin më të mirë kur bëhet fjalë për mikpritjen”, thotë instituti me qendër në Këln. “AfD sulmon pamëshirshëm

emigrantët dhe është e kënaqur me rezultatet e saj të mira në sondazhe”. “Süddeutsche Zeitung” raportoi për një dokument të Partisë së Gjelbër, në të cilin politikanët e lartë të partisë listojnë 15 masa për të luftuar mungesën e fuqisë punëtore dhe punëtorëve të kualifikuar në Gjermani. Një nga kërkesat kryesore është heqja e ndalimit të punës së refugjatëve. “Është absurde që njerëzve që kërkojnë mbrojtje nga persekutimi politik apo kërcënimet ndaj jetës në Gjermani u ndalohej të punojnë këtu”, thuhet në dokument. Kancelari Federal Olaf Scholz (SPD), Ministri i Ekonomisë Robert Habeck (Të Gjelbërit) dhe Ministri i Financave Christian Lindner (FDP) kishin rënë dakord tashmë në korrik, gjatë negociatave të tyre

mbi buxhetin federal 2025, për të reduktuar pengesat burokratike në mënyrë që të huajt të kenë akses në punësim. Habecku tha atëherë se qëllimi ishte për të ndryshuar kompetencat e autoriteteve të imigracionit. Në të ardhmen do të vlejë: “Nëse nuk kundërshtojnë pas 14 ditësh, puna e të huajve do të konsiderohet e autorizuar”. Në dokumentin e tyre, politikanët kryesorë të Gjelbër kërkojnë gjithashtu krijimin e një agjencie qendrore të imigracionit. Përveç kësaj, anglishtja duhet të autorizohet si gjuhë e dytë në zyrat publike. Edhe njohja e kualifikimeve dhe diplomave profesionale duhet të jetë më e shpejtë dhe më e lehtë. Së fundi, të Gjelbërit gjithashtu kërkojnë në dokument që të përshpejtohet dhënia e vizave.



Hapja e urës së Ibrit, Ramadani: Pauza e urrejtjes dhe arrogancës nga pushteti



PRISHTINË, 26 GUSHT - Zyrtarët e pushtetit, kanë pushuar me deklarime për hapjen e Urës së Ibrit. Një ndër më të zëshmit, deputeti i Vetëvendosjes, Mefail Bajqinovci, i është kthyer temave të tjera, ngjashëm edhe disa eksponentë të tjerë të partisë në pushtet. E kjo “heshtje” duket se vjen pas vizitës së shefit të CIA-së në Kosovë, Willaim Burns. Ish-kryeinspektori i AKI-së, Burim Ramadani, ka thënë se po vërehet një pauzë e urrejtjes dhe arrogancës nga pushteti i Vetëvendosjes. “Pauza e urrejtjes dhe arrogancës nga pushteti. Nga e premtja vërehet një mungesë e përhapjes publike së urrejtjes dhe manifestimit të arrogancës nga

pushteti. Mbetet të shihet nëse kjo është vetëm një pauzë momentale apo kanë ‘mësuar’ çka nuk guxojnë të bëjnë më! Gjuha helmuese e eksponentëve të pushtetit ndaj faktorit ndërkombëtar, SHBA-ve, NATO-s, KFOR-it, BE-së, opozitës, shoqërisë civile, mediave, bizneseve, sindikatave etj., ka dëmtuar seriozisht shëndetin e shtetit tonë! Dëmi u bë. ‘Serumi’ i të premtës e ndaloi momentalisht gjuhën helmuese, por rikuperimi merr kohë. Pyetja themelore që mbetet: A dinë këta të propagandojnë pa përhapje të urrejtjes dhe manifestim të arrogancës apo thjesht janë çarmatosur?”, ka shkruar Ramadani në “Facebook”.

Ballkoni panoramik, investim për transformim të turizmit në Rahovec

Rahovec, 26 gusht- Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Larifi, ka njoftuar për fillimin e punimeve për ndërtimin e ballkonit panoramik mbi qytetin e Rahovecit. “Sot, bashkë me ministrin e Zhvillimit Rajonal, Fikrim Damka, me bashkëpunëtorë e me qytetarë, mora pjesë në

fillimin e punimeve të projektit ‘Ndërtimi i Ballkonit Panoramik mbi qytetin e Rahovecit’, bashkëfinancim i Komunës së Rahovecit dhe MZHR-së. Ky projekt, që e kemi quajtur ‘Grape city’, është një hap i rëndësishëm në drejtimin e zhvillimit të turizmit të qytetit tonë. Ky ballkon do të

shërbejë si një vend unik për vizitorët dhe për qytetarët tanë, duke ofruar pamje të peizazhit të mrekullueshëm që na rrethon. Kjo është njëra ndër përpjekjet tona të pandalshme për ta bërë Rahovecin një vend të denjë për vizitorë dhe një qytet për të cilin jemi krenarë të gjithë”, ka thënë Latifi.



Kurti takon pjesëmarrësit e Seminarit të 42-të Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare

PRISHTINË, 26 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, së bashku me ministren e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka pritur në takim pjesëmarrësit e Seminarit të 42-të Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare.

Ky seminar është themeluar më 1974 dhe këtë vit shënon 50-vjetorin e tij, teksa edicioni i 42-të me radhë, ka mbledhur kësaj here rreth 300 pjesëmarrës, ndër ta dhe albanologë nga e gjithë bota.

Kryeministri Kurti me këtë rast tha se është i nderuar nga kjo vizitë e studiuesve të gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare, ndërsa i falënderoi ata për angazhimin e vazhdueshëm dhe kontributin e çmuar përmes pjesëmarrjes në këtë seminar.

Ai shtoi se gjurmët e punës së studiuesve të gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare vërehen



gjithandej, qoftë tek njerëzit të cilët punojnë dhe lëvrojnë gjuhën dhe letërsinë tonë, por gjithashtu edhe te veprat të cilat

lexohen e botohen.

Ndër të tjera, foli edhe për rëndësinë e historisë së gjuhës dhe historinë e popullit tonë, për

të cilat shprehu se nuk mund të ndahen apo mësohen veçmas njëra nga tjetra. U diskutua edhe për raportin e përdorimit të

gjuhës me zhvillimin e teknologjisë, e sidomos në lidhje me inteligjencën artificiale, shanset dhe rreziqet përkatëse. Ai ka thënë se Qeveria përmes MASHTI-t e ka mbështetur organizimin e këtij seminari, e këtë vit si rezultat i Memorandumit të Mirëkuptimit me Universitetin e Prishtinës, si dhe do të vijojë të përkrahë iniciativë të tjera të cilat shërbejnë për studimin, njohjen dhe zbërthimin e gjuhës, letërsisë, kulturës dhe historisë sonë.

Sivjet në këtë ngjarje të ftuar janë disa prej figurave më eminente të albanologjisë e gjuhës në botë, si gjuhëtari Brian Joseph, akademiku Ranko Matasović, profesori Jose Manuel Floristan Imizcoz, ligjëruesi Phil Hubbard, që kthehet në ngjarje pas 47 vjetësh, albanologu Rexhep Ismajli e historiani Oliver Jens Schmitt.

Takim pune i policisë së Gjilanit dhe Këshillit Lokal për Siguri Publike



GJILAN, 26 GUSHT - Në ambientet e Stacionit Policor në Gjilan, komandanti i Stacionit Policor Gjilan major Agim Lipovica së bashku me Njësitin Sektorial dhe të Komunitetit, kanë mbajtur një takim me përfaqësuesit e Këshillit Lokal për Siguri Publike të fshatit Cërnica.

Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi dhe diskutimi i çështjeve të sigurisë publike, identifikimi i sfidave aktuale, bashkëpunimi për zgjidhjen e tyre në mënyrë efektive si dhe parandalimi i zjarreve e i dukurive negative.

Përfaqësuesit e këtij këshilli gjatë

këtij takimi shprehën mirënjohje të thellë për bashkëpunimin e ngushtë dhe përkushtimin e policisë së Gjilanit për adresimin e shqetësimeve të qytetarëve dhe angazhimit të Policisë për krijim të një ambienti të qetë dhe sigurt për të gjithë.

Në Skenderaj hapet panairi për bizneset lokale, fermerët dhe shoqatat e grave

SKENDERAJ, 26 GUSHT - Nën organizimin e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, Ndërmarrësi, Inovacion dhe Turizëm, në Sheshin “Adem Jashari” në Skenderaj është hapur panairi i përgjithshëm, në të cilin bizneset lokale, fermerët dhe shoqatat e grave, kanë ekspozuar

produktet e tyre. Kryetari i Komunës, Fadil Nura dhe drejtoresha për Zhvillim Ekonomik, Ndërmarrësi, Inovacion Besarta Meha - Ademi, kanë marrë pjesë në hapje të këtij panairi, në të cilin janë ekspozuar produkte ushqimore,

artizanale, vepra arti, prodhime bujqësore e veshje tradicionale. Ky panair është pjesë e programit të qeverisjes lokale, e cila synon promovimin e kulturës dhe traditës shqiptare, dhe do të jetë i hapur për tri ditë në vazhdim.



S’lejohen më në oborrin e QKUK-së ambulancat e spitaleve private, automjetet për bartjen e kufomave dhe taksitë

PRISHTINË, 26 GUSHT - Qendra Klinike Universitare të Kosovës ka njoftuar se në përputhje me masat për menaxhimin dhe organizimin e hapësirave në QKUK; autoambulancat e spitaleve private, automjetet për bartjen e kufomave dhe veturave të taksive, nuk do t’u lejohet të qëndrojnë në oborrin e QKUK-së.

Ky vendim është marrë për të përmirësuar efikasitetin e shërbimeve emergjente dhe për të lehtësuar lëvizjen dhe qarkullimin brenda oborrit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, me ç’rast të lirohet parkingu i QKUK-së, për pacientë.

Kjo masë është e nevojshme për të siguruar që hapësira dhe parkingu i QKUK-së, të jetë i dedikuar për emergjencat dhe pacientët që kanë nevojë për shërbime të menjëhershme, si dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve mjekësore për të gjithë qytetarët.



Zhitia: Avokatë dhe prokurorë shkoqitën fjali nga libri im, të cilat në opinion e kanë përcjellë një mesazh të gabuar

HAGË, 26 GUSHT - Dëshmitari Skender Zhita gjatë dëshmisë së tij të hënën në Hagë, tha se avokatë dhe prokurorë nga Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK), kanë shkoqitur fjalë dhe fjali nga libri i tij, të cilat në opinion më pas kanë përcjellë mesazh të gabuar.

Këtë deklaratë, dëshmitari e bëri pasi u pyet nga prokurorja Silvia D’Ascoli se a e ka ribotuar ndonjëherë librin e tij. “Po, e kam ribotuar në vitin 2023 pa ndryshime. Arsyeja e ribotimit është fakti që nga kjo dhomë, avokatë por edhe prokurorë kanë shkoqitë fjalë dhe e fjali nga tanësia e librit tim, të cilat në opinion e kanë përcjellë një mesazh të gabuar”, tha dëshmitari.

Përpara kësaj, Zhitia u pyet për një pjesë të librit ku përshkruhen ngjarje në Zonën Operative të Llapit nga 24 marsi 1999 deri më 1 maj të vitit 1999.

Ai pohoi se është i saktë informacioni që e ka pasqyruar në libër, ku kishte treguar se pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, në Zonën Operative të Llapit kishte filluar ofensiva serbe dhe se Serbia kishte filluar me planin ‘Patkoi’ për dëbimin e shqiptarëve, raporton “Betimi për Drejtësi”. “Po, ato të cilat kishin për qëllim dëbimin e popullatës civile nga rajoni i Zonës Operative të Llapit, por është një operacion i bazuar në planin “Patkoi’ të Serbisë në atë kohë i cili filloi me fillimin e bombardimeve të NATO-s dhe ky operacion filloi nga pjesa më veriore e Kosovës, respektivisht nga zona Operative e Llapit. Kështu që u mobilizuan të gjitha njësitë në atë kohë që t’i dalin në ndihmë popullatës për t’u evakuuar dhe larguar nga regjionet të cilat ishin me të rrezikueshme. Pra, tek ‘Patkoi’ kemi çka të shtojmë dhe të themi”, tha Zhitia.



Rritja e rasteve me Covid-19, nuk është shqetësuese

Prishtinë, 26 gusht - Kryeshefi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë, Valdet Hashani, ka thënë se gjatë dy javëve të fundit është rritur numri i pacienteve me Covid-19.

Ai ka thënë se ky numër është më i madh se sa të dhënat zyrtare, pasi sipas tij një numër i madh i pacienteve nuk janë duke u testuar për virus.

Hashani ka theksuar se numri në rritje me këto viruse nuk ka asgjë për t’u shqetësuar, dhe se këto raste me terapi invazive janë duke u shëruar brenda dy deri në tri ditë. “Realisht në dy javët e fundit kemi një rritje të fluksit të pacientëve, sigurisht se pjesa dërmuese e kësaj rritje korrespondon me diagnozën e virozave sezonale të verës. Në kuadër të kësaj numri më i madh i pacientëve është me Covid pozitiv. Numri nuk mund të themi në shifra, sepse këto të dhëna tashme i keni edhe nga IKShPK-ja. Po mund t’ju them se numri i pacienteve është shumë më i madh, por nuk ka asgjë shqetësuese. Ndoshta pak a shumë simptomatologjia është më e shprehur se virozat e tjera, por megjithatë edhe me terapi joinvazive, pa infuzione e të ngjashme ajo po kalon brenda dy tri ditëve”, ka thënë Hashani për “EO”.



Në Jarinjë arrestohet serbi Dushan Neshiq

Prishtinë, 26 gusht- Dushan Neshiq, me kombësi serbe, u arrestua në Jarinjë - vendkalim kufitar mes Kosovës dhe Serbisë, konfirmoi për Radion Evropë e Lirë zëdhënësi i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani. Ai tha se arrestimi është bërë në bazë të një urdhri gjyqësor për një rast të vitit 2022, që ka të bëjë me “kërcënime”. “Personi është ndaluar të hënën rreth orës pesë të mëngjesit, teksa po hynte në Kosovë nga Serbia. I dyshuari është ndaluar për 48 orë dhe gjendet në stacionin policor në Mitrovicën e Jugut”, tha Elshani.

Ai nuk dha më shumë detaje rreth rastit, e as për kërcënimet që mund të jenë në pyetje.



Krasniqi: Marrëveshjet ndërkombëtare dëmtojnë bizneset, nevojitet rinegociim i menjëhershëm



PRISHTINË, 26 GUSHT - Kryetari i Dhomës së Tregtisë e Industrisë, Skënder Krasniqi ka ngritur shqetësimin e tij mbi ndikimin negativ të marrëveshjeve ndërkombëtare në ekonominë e Kosovës.

Në një intervistë për KosovaPress, Krasniqi ka kritikuar ashpër efektet e marrëveshjeve të nënshkruara nga Kosova, duke theksuar se

këto marrëveshje nuk kanë mbrojtur mjaftueshëm interesat e bizneseve vendore dhe se kanë kontribuar në një rritje të importit të produkteve të huaja pa ndonjë përfitim të dukshëm për eksportet kosovare.

Ai derisa ka kërkuar nga shteti të merr më seriozisht gjendjen e tanishme të vendit, thotë se rënia e ngadalësuar e remitencave nga diaspora, e cila,

është bërë e ditur në raportin për vlerësimin tre mujor të ekonomisë të publikuar nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), do të ndikojë negativisht edhe në qarkullimin e brendshëm të blerjeve brenda vendit.

Derisa shton se çdo marrëveshje që është nënshkruar nga ana e Kosovës në raporte me tregti të lirë ka qenë më shumë dëm sesa

në përfitim të Kosovës, dhe më shumë kanë përfituar ato vende. Sa i përket udhëzimit administrativ të nxjerrë nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për kuotat në import, Krasniqi ka thënë se duhet të jetë i kujdesshëm në veprim për shkak se mund të bie ndesh me këto marrëveshje ndërkombëtare.

Hoti: E papranueshme anashkalimi i BSPK-së në zgjedhjen e anëtarit të Bordit të Trustit

PRISHTINË, 26 GUSHT - Deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ka kritikuar sërish Qeverinë e Kosovës.

Ai ka thënë se është “e papranueshme” që në zgjedhjen e anëtarit të bordit të Trustit të anashkalohej BSPK-ja dhe të përzgjidhet një person që nuk plotëson kriteret ligjore.

Ai u ka bërë thirrje sindikatave që të bëhen bashkë për të parandaluar këtë shkelje. “Është e papranueshme që në zgjedhjen e anëtarit të Bordit të Trustit Pensional që përfaqëson punëtorët, të anashkalohej BSPK-ja dhe të përzgjidhet një person që sipas

evidencës së ofruar nga BSPK-ja nuk i plotëson kriteret ligjore për të qenë përfaqësues i punëtorëve në Bordin e Trustit Pensional që menaxhon kursimet pensionale të punëtorëve. Unë ftoj të gjitha sindikatat të bëhen bashkë për të parandaluar këtë shkelje. Shihni letërnë e BSPK-së dërguar Kuvendit të Kosovës dhe anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Në fakt, kjo sjellje e qeverisë nuk është asgjë e re tanimë. Gjatë mandatit të kësaj qeverie është mbytur dialogu social. Qeveria ka luftuar sindikatat me të gjitha mjetet. Puna e Këshillit Ekonomik-Social është

paralizuar. Pagesat simbolike që punëtorët kanë bërë si kontribut i anëtarësisë në sindikata tani kontrollohen nga Qeveria dhe tani këto lloj pagesa janë përgjysmuar. Secili sindikalist që ka kundërshtuar qeverinë është linçuar nga zyrtarë e militantë të partisë në pushtet, të cilat linçime janë pasuar me veprime të tjera në organizatën përkatëse”, ka thënë Hoti.

Ai ka shtuar se këta mashtgues që bëjnë thirrje për fuqizim të sindikatave në sektorin privat po e pengojnë me çdo formë organizimin sindikal në sektorin publik.



Forumi Ekonomik i Grave i reagon Qeverisë për heqjen e Ligjit për Punën nga Kalendari Legjislativ

PRISHTINË, 26 GUSHT - Forumi Ekonomik i Grave, përmes një reagimi publik ka shprehur zhgënjimin e thellë ndaj Qeverisë së Kosovës, pas vendimit të saj për të hequr Ligjin për Punën nga Kalendari Legjislativ.

Në reagim thuhet se “përkundër kërkesave të përsëritura dhe reagimeve të shumta nga grupet e interesit, përfshirë një letër të dërguar më 15 shkurt 2024, qeveria nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret për këtë çështje jetike”. “Ky ligj ka qenë në proces ndryshimi që nga viti 2018 dhe konsiderohet thelbësor për avancimin e barazisë gjinore dhe përmirësimin e mirëqenies sociale në vend. Në fushatën elektorale, qeveria kishte premtuar se mirëqenia sociale



do të ishte ndër prioritetet kryesore, por deri më tani nuk janë adresuar çështjet themelore të mbrojtjes së të drejtave të punës dhe barazisë në Kosovë”, thuhet në njoftim. Më tej, theksohet se “disa nga pikat kyçe që neve na shqetësojnë janë se vetëm 2 në

10 gra janë të punësuar, dhe ky realitet ka ndryshuar shumë pak me kalimin e kohës”. “Për shkak të mangësive në mbrojtjen e punës, gratë vazhdojnë të kryejnë punë joformale në shtëpi, pa pagesë, pa njohje, pa mbrojtje të të drejtave të punës ose pa

pensione, gjë që ndikon në varfërinë e tyre më vonë në jetë. Ligji aktual i punës ndikon drejtpërdrejt në përjashtimin e grave nga fuqia punëtore për shkak të diskriminimit gjinor në punësim, pasi punëdhënësit shmangin përgjegjësinë e pagesës së pushimit të lehonisë. Ndërkohë, burrat nuk kanë të drejta të barabarta për të kaluar kohë me fëmijët e tyre. Ky ligj diskriminon drejtpërdrejt baballarët, duke shkelur të drejtat e tyre të barabarta sipas Ligjit për Barazi Gjinore”, thuhet në reagim.

Forumi Ekonomik i Grave shton tutje se Kosova ende nuk e ka harmonizuar Ligjin e Punës me Direktivën e BE-së për Balancën midis Punës dhe Jetës, dhe ende nuk i mbron të drejtat e kujdestarëve, të vetëpunësuarve

dhe shumë të tjerëve. “Forumi Ekonomik i Grave thekson se shtyrja e mëtejshme e miratimit të amendamenteve në Ligjin për Punën do të rezultojë në vazhdimin e shkeljeve të të drejtave të grave dhe burrave në Kosovë. Kërkojmë nga qeveria që menjëherë të publikojë për diskutim Projektligjin e ri, të zhvillojë konsultime të gjera me të gjitha palët e interesuara, përfshirë organizatat për të drejtat e grave dhe sindikatat, dhe ta përfshijë këtë ligj thelbësor në kalendarin legjislativ të këtij viti. Nëse brenda një periudhe të shkurtër nuk ndërmerren veprime konkrete, Forumi Ekonomik i Grave paralajmëron mobilizim të gjerë dhe reagime të vazhdueshme derisa të përmbushen kërkesat”.

Haradinaj: Kosova, edhe pse vend i vogël ka potenciale të mëdha për zhvillimin e bujqësisë e blegtorisë

VUSHITRI, 26 GUSHT - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka vizituar Gëzim Hajdarin nga Novolani i Vushtrisë, për të cilin thotë se është bërë një fermer i suksesshëm pa ndihmën e askujt. “Ai sot në fermën e tij, ka dhjetëra krerë buallica, të cilat në territorin e Kosovës pothuajse janë në zhdukje. Përveç që rritjen e

mbarështimin e tyre e ka shndërruar në një biznes të suksesshëm, me të cilin e siguron jetesën e familjes së vet, ai e ruan edhe një trashëgimi nga stërgjyshërit. Gëzimi është shembull i një njeriu që nuk është dorëzuar para vështirësive, por ka mijëra të tjerë, të cilët në mungesë të një mbështetjeje nga shteti, e kanë

pasur të pamundur që të merren me këtë veprimtari”, ka thënë Haradinaj.

Ai ka shtuar se Kosova, edhe pse vend i vogël ka potenciale të mëdha për zhvillimin e bujqësisë e blegtorisë, por mungesa e vizionit dhe politikave shtetërore për zhvillimin e këtij sektori, e ka lënë në fundin e listës.



Gjithmonë me pushime? Nuk është zgjidhje...



Qëndrimi në breg të detit dhe më pas kthimi në jetën tuaj të zakonshme kanë të përbashkët diçka të mirë : thejnë rutinën. Dhe mesa duket kjo na duhet shumë, për t'u mësuar. Shkëputja është e vetmja mënyrë për të qenë në gjendje të vlerësojmë vendet dhe marrëdhëniet që në një moment të caktuar na duken të mërzitshme, por edhe e vetmja metodë për të mos justifikuar situatat toksike që nuk i dallojmë, sepse jemi mësuar me to. Duhet të shikojmë larg që të mund të shohim mirë. Neuroshkencëtarja me famë botërore Tali Sharot, nga University College London, dhe Cass R. Sunstein, ekonomist në Harvard, e përshkruajnë në një ese shumë interesante, Look Better. “Edhe gjërat që dikur i keni parë si emocionuese e humbasin shkëlqimin pas një kohe”. “Kërkimet shkencore thonë se njerëzit fillojnë të mësohen me magjinë e një pushimi në Tropik brenda 43 orëve nga mbërritja”.

Reagojmë ndaj të papriturave

Ne reagojmë gjithnjë e më pak ndaj stimujve që përsëriten: jemi të strukturuar kështu, i bindemi një parimi të thjeshtë. “Nëse ndodh diçka befasuese ose e papritur, truri do të përgjigjet me intensitet të madh,” vazhdojnë autorët. “Megjithatë, kur gjithçka është e parashikueshme, ai përgjigjet më pak, ndonjëherë nuk përgjigjet fare. Siç ndodh me

faqen e parë të një gazete, trurit i intereson ajo që ka ndryshuar kohët e fundit, jo ajo që ka mbetur e njëjtë. Kjo sepse për të mbijetuar, truri duhet t'i japë përparësi asaj që është e re dhe e ndryshme: era e papritur të tymit, një luan grabitqar që vrapon drejt jush ose një partner potencial tërheqës që ecën pranë. Që të bien në sy e reja dhe e papritura, truri filtron dhe përjashton të vjetrën dhe të pritshmen”.

Mekanizmi në terma shkencorë quhet të “mësuarit” dhe është gjithashtu i pranishëm tek jovertebrorët, siç vërehet nga eksperimentet në një kërmilli deti, *Aplysia californica*, i dashur nga studiuesit për madhësinë e madhe të neuroneve të tij. Kur preket molusku, ai adopton sjellje mbrojtëse dhe përpëlitet. Por nëse i njëjti stimul ndodh në mënyrë të përsëritur dhe nuk është kërcënues, për shembull sepse përfshin spërkatje uji, refleksi mbrojtës nuk nxitet më. Ai mëson të mos ketë frikë nga deti. Zakoni na kursen shumë ne sapienëve, përndryshe do të jetonim në një gjendje ankthi të përhershëm. Sidoqoftë, duhet të gjejmë një rrugë të mesme midis rrënjëve, arritjeve dhe trukeve tona, në mënyrë që të mos mërzhitemi. Pushimet e shkurtra, për shembull, mund të ndërpresin rutinën dhe të gjenerojnë kënaqësi.

Teoria e kënaqësisë së ndërprerë

Ekonomisti hungarez Tibor

Scitovsky hodhi hipotezën se kënaqësia vjen nga plotësimi i ndërprerë i dëshirave. Do të thotë që aspektet e këndshme të jetës na sjellin kënaqësi nëse i përjetojmë herë pas here. Nëse ato përvoja bëhen të përditshme, do të prodhojnë rehati dhe jo kënaqësi të vërtetë. Scitovsky i referohet pasurisë, por sipas autorëve të librit “Shiko më afër”, teoria mund të shtrihet në aspekte të tjera të ekzistencës. Ata citojnë një studim shkencor në lidhje me këtë, të botuar në vitin 2011 në American Journal of Clinical Nutrition: “Një ekip studiuesish rekrutuan disa njerëz dhe i ndanë rastësisht në dy grupe, njëri prej të cilëve merrte një pjatë makarona me djathë çdo ditë për një javë. Në fillim, atyre u pëlqeu vërtet pjata, por gradualisht, me çdo ditë që kalonte, u dukeshin gjithnjë e më pak tërheqëse makaronat dhe djathi. Ata thjesht u mësuan me atë pjatë. Pothuajse çdo stimul që përjetohet në mënyrë të përsëritur gjatë një periudhe të shkurtër kohore, qoftë një kopsht lulesh apo grumbuj mbeturinash në trotuar, do të ngjallë një reagim emocional gjithnjë e më pak të fortë, qoftë pozitiv apo negativ. Grupit tjetër të pjesëmarrësve iu shërbyen një pjatë me makarona dhe djathë një herë në javë për pesë javë. Ata e pëlqyen javën e parë. E pëlqyen javën e dytë. E pëlqyen javën e tretë. E me radhë. Nuk pati ulje të nivelit të kënaqësisë me makaronat dhe djathin, sepse kënaqësia vjen nga plotësimi i ndërprerë i dëshirave”.

Të mësuarit është një mënyrë për të ndryshuar

Një pushim, sado i shkurtër, ju lejon të perceptoni jetën tuaj me sy të rinj. Kur e ndërpresim realitetin, ne mund të përparojmë, duke u çliruar nga zakonet, duke modifikuar një detaj të vogël ose duke revolucionarizuar botën tonë. Si të ndryshohet? Për shembull, duke studiuar. “Ti mësohesh me gjërat – një makinë luksoze, një televizor me ekran të madh – por nuk mësohesh me gëzimin e të mësuarit, sepse të mësuarit është, sipas definicionit, ndryshim”, shkruajnë Tali Sharot dhe Cass R. Sunstein. “Nuk mund të mësohesh me ndryshimin”. Në veprën e Oscar Wilde “Rëndësia e të qenit i sinqertë”, Jack Worthing i thotë të dashurës së tij, Lady Gwendolen Fairfax, se ajo është e përsosur dhe ajo përgjigjet: «Oh! Unë shpresoj që jo. Nuk do të kishte asnjë mundësi të mëtejshme për përparim dhe unë synoj të bëj përparim në shumë drejtime”. Përparoni, përmirësoni. Një jetë dinamike, madje edhe futja në faqet e një libri, duket çelësi për të kultivuar një ndjenjë më të madhe mirëqenieje.

Kriza e moshës së mesme

Sipas esesë së neuroshkencëtares dhe ekonomistit, stabiliteti i tepërt është një nga arsyet kryesore për krizën e moshës së mesme, që e gjen në shumë pjesë

të botës, mesatarisht midis moshës 48 dhe 62 vjeç. Kur je i ri, komentojnë ata, gjithçka mund të ndodhë: «Mund të biesh në dashuri, sot ose nesër, dhe mund të mësosh diçka që do të të transformojë plotësisht ose do të të ndryshojë jetën. Megjithatë, rreth moshës së mesme, shumë njerëz ndihen sikur kanë ngecur. Ata mendojnë se gjërat janë të qëndrueshme dhe do të mbeten të tilla për një kohë të gjatë”. Stabiliteti nuk është gjë e keqe, por ka më pak rrethana të panjohura ose të paparashikueshme. Si të largohesh nga zakoni? Studimet vërtetojnë se kënaqësia me të mirat materiale bie ndjeshëm, ndërsa kënaqësia me përvojat nuk bie. Gëzimi që ndjen për një fustan të sapo blerë dhe për një udhëtim mund të jetë i ngjashëm në fillim, por vëmendja ndaj veshjes bie, ndërsa habia nga madhështia e disa monumenteve ose magjepsja prej disa peizazheve të lë një shije që mbetet përgjithmonë. “Ndikimi i vazhdueshëm i përvojave në lumturi, krahasuar me ndikimin kalimtar të zotërimit të një objekti material, mund të jetë një nga arsyet pse ne kemi më shumë gjasa të pendohemi që nuk kemi prenotuar një palë pushime, sesa që nuk kemi blerë diçka”, komentojnë autorët.

Eksplorues

Të gjithë i përkushtohen pak pozicioneve që kanë fituar dhe pak eksplorimit të gjërave të reja. Kthehemi në restorantet dhe butikët tanë të preferuar, por ndonjëherë na pëlqen të zbulojmë vende dhe dyqane të tjera. Pika e ekuilibrit ndryshon shumë nga një person në tjetrin. Ndoshta ata që mësohen lehtësisht me status quo-në tërhiqen më shumë nga ndjesi të ndryshme. “Për të qenë të qartë, ne nuk duam t’ju këshillojmë të ndaheni ose të lini punën!” saktësojnë dy eseistët. Natyrisht: nuk duhet domosdoshmërisht të ndryshoni kurs. Studimet tregojnë se mesatarisht njerëzit janë më të lumtur kur ndryshojnë një prirje nga e cila tashmë janë lodhur, por studimet tregojnë gjithashtu se njerëzit priren, për shkak të një lloj dembelizmi mendor, të mos ndryshojnë asgjë. “Ne njerëzit mund të përshtatemi shumë”, thuhet në libër. “Është e lehtë të përfundoni si somnambul në një gjendje stresi dhe shpërqëndrimi kronik, pa menduar që gjërat mund të jenë ndryshe”. Duhet të kemi kujdes, sepse zakoni na bën të verbër. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Akinbule pasi fitoi çmimin “Ylli i javës” në Superligë: Synojmë titullin

“Epoka e re”

PRISHTINË, 26 GUSHT - Federata e Futbollit të Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall e kanë ndarë çmimin “Ylli i javës” për xhiron e tretë, i cili i ka takuar futbollistit të FC Prishtina, Ayonfe Sunday Akinbule. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i veteranëve të futbollit në përbërje: Skënder Kapra, Blerim Haxholli dhe Berat Berisha. Ky komision vendosi që çmimi t’i takojë Akinbules, i cili realizoi dy gola dhe asistoi për golin e tretë, duke i siguruar fitoren e parë ekipit të tij në elitë, FC Prishtina, kundër FC Ferizaj (3-1). Pasi mori këtë çmim, Sunday u shpreh i lumtur që u

vlerësua si më i miri i javës. “Së pari, kjo më bën të ndihem shumë i lumtur dhe vërtet jam i gëzuar që jam shpallur lojtari më i mirë i javës. Pra, për mua, është një gjë shumë e mirë dhe një fillim shumë i mirë në këtë moment. Po e shijoj Kosovën dhe gjithashtu po e shijoj ligën. Liga ka vitalitet dhe gjithçka këtu është shumë mirë. Po ashtu, ekipi i Prishtinës është shumë i mirë dhe po bëjmë një punë të shkëlqyer me trajnerin, me bordin dhe gjithashtu me mbështetje nga federata. Momentalisht, gjithçka po shkon mirë për mua. Me cilësinë e trajnerit dhe cilësinë e lojtarëve që kemi në ekip, e shoh Prishtinën si një ekip që do të dalë i pari, kampion i ligës”, ka thënë

Akinbule për faqen zyrtare të FFK-së. “Unë besoj në ekipin tim. Besoj në punën e trajnerit dhe gjithashtu e di se do të jetë një sfidë e madhe për ne që të jemi në krye të tabelës. Por ne jemi këtu për t’u përballur me sfidat dhe do ta bëjmë këtë me punë të palodhur. Sigurisht, asgjë nuk është e pamundur. Çdo gjë është e mundur. Ne mund ta bëjmë këtë. Dua të falënderoj trajnerin dhe bordin për punën e palodhur që kanë bërë për ekipin. Ata na ndihmojnë të tregojmë talentin tonë dhe të bëhemi lojtarë të shkëlqyer. Falënderoj gjithashtu federatën që po bën të mundur që gjithçka të shkojë mirë në ligë. Shpresojmë që të bëhemi kampionë dhe të festojmë”, ka shtuar Akinbule.



Sylvinho: Tani e dua Botërorin

TIRANË, 26 GUSHT - Rreth dy javë nga ndeshja e parë e Ligës së Kombeve, ajo me Ukrainën më 7 shtator në transfertë, trajneri Sylvinho ndodhet në Tiranë për të startuar aventurën e tij të dytë në drejtimin e kuqezinjve. Megjithatë rinovimi me të nuk ishte krejt i thjeshtë, apo pa negociata. U prit përfundimi i kontratës së parë dhe më pas rifilluan bisedimet. Në një intervistë për “Top Channel”, trajneri i kombëtares shqiptare tregon prapaskenat. Çfarë ndodhi? A kishte mëdyshje ai për të vazhduar me kombëtaren tonë? Apo priti çfarë ofertash mund të merrte pas ecursisë së sezonit të parë thuajse perfekt me kualifikimin në Evropian? “Jo, jo jo, nuk kam pasur dhe as unë nuk shkova të kërkoj. Gjithmonë e them kjo e trajnerit është një jetë e vështirë por shumë e bukur. Unë nuk e kisha menduar kurrë që do të vija një ditë dhe të drejtoja kombëtaren e Shqipërisë, jemi në kahe të ndryshme të globit, por ja që jeta na vendosi në këtë vend shumë të bukur. Unë dhe Doriva jetojmë në Tiranë dhe po e jetojmë këtë sfidë, është shumë e bukur. Secili duhet të jep kontributin e tij dhe në këtë formë arritëm të shkonim në Evropian për herë të dytë dhe nuk është aspak e thjeshtë ju e dini”, ka thënë ai.

Po si është kontrata e tij e re, përfitoi ai më tepër para, apo ishte



presidenti Duka ai që i ka rritur më tepër kërkesat ndaj stafit teknik në aspektin e objektivave?

Sylvinho: Marrëdhënia me Federatën dhe veçanërisht me presidentin është shumë e mirë. Ne i dimë përgjegjësitë tona, kishim si sfidë kualifikimin në evropian dhe arritëm, por të gjithë bashkë, në asnjë moment të vetëm nuk e mendoj që jam unë dhe e bëra unë apo stafi im i vetëm. Por ne e dimë se çfarë është sfida jonë, kemi Ligën e Kombeve që po punojmë, kemi filluar punën që tani për Gjeorgjinë dhe Ukrainën, kemi edhe Çekinë kundërshtarë shumë të vështirë. Ne duhet të punojmë shumë dhe të përmirësohemi, gjithmonë duke

pasur një synim, kualifikimin për në Botëror.

Megjithatë Evropiani me shumë emocioneve të bukura të përjetuara dhe të dhuruara pati edhe diskutimet, pakënaqësitë dhe të humburit, që ishin disa lojtarë që nuk ishin të përfshirë në këtë event historik për ne.

Sylvinho: Unë mund të them se ne tani jemi me fat, në kuptimin që kemi rreth 35 lojtarë me të cilët mund të luajmë, por unë duhet të merrija 23, 25 apo 26. Më pas jam unë ai që duhet të vendos, për fat të mirë apo të keq. Sa i përket Uzunit, ai me ne ka luajtur si lojtarë krahu në sulm, ndërkohë që tek klubi i tij luan si qendër

sulmues apo si sulmues i dytë. Ai ka bërë një sakrificë me ne, ka luajtur ka dhënë maksimumin, por ai është një sulmues dhe atje, në klubin e tij luan si sulmues. Pasi e diskutuam menduam që thjeshtë ai është një sulmues dhe në pozicionin ku ne e përdornim duhet të provonim një lojtarë tjetër. Ky është vetëm një emër një pozicion, por mund të flasim për të 35 apo 40 lojtarët që kemi. Unë e kuptoj pozitën e atij dhe mërzi tjetër se kam qenë vetë, unë për shembull kam provuar të qëndroj në stol, të më çojnë në tribunë apo dikur më ka mbaruar një kontratë dhe më kanë thënë, nuk na duhesh më. I kam bërë të gjitha. Por unë jam profesionist dhe e vetmja gjë që s’më lejohet të bëj është që të mos arsyetoj me zemër, sepse unë kam përgjegjësi përballë federatës, njerëzit dhe të gjithë vendit.

Po a ishte ajo që kem parë në eliminatorë dhe në evropian maksimumi i Sylvinhos, i trembet ai një historie që për ne është “deja vu” si ajo me De Biasin, kur në tentativën e tij të dytë u largua në mes të edicionit?

Sylvinho: Jeta e një trajneri është shumë më e keqe se e një futbollisti. Lojtarët e kanë një kontratë dhe mbahen aty, ndërkohë që edhe trajneri e ka kontratën, por gjërat ndryshojnë dhe mund të ndodh gjithçka. Unë

jam shumë i kënaqur me punën e bërë deri këtu dhe federate gjithashtu është, kështu që duhet të provojmë, më pas nëse ndodh diçka dhe të them se është në dhjetor në janar apo qershor, nuk mund të bëj parashikime.

Cila është më e mira që Sylvinho i dha Shqipërisë dhe gabimi që ai bëri me Shqipërinë?

Sylvinho: Kualifikimi në evropian. Kjo është pjesa më e mirë për mua ishte ëndërr. Ndërkohë gjëja e keqe që më ndodhi? Unë jam një njeri kërkues dhe pse kishim një grup shumë të vështirë, ishte mundësia që patëm dhe nuk arritëm të shkonim në 8-tshe dhe nuk shkuam.

Si do të luaj kombëtarja jonë në këtë epokë të dytë të Sylvinhos, për të shkua në Botëror por edhe në Ligën e Kombeve?

Sylvinho: Gjëja më e mirë që patëm dhe duhet ta theksoj është moduli i lojës që ne ndryshuam nga kualifikimet në finalët e evropianit. Ishte e ndryshme. Ne e filluam me dy lojtarë përpara mbrojtjes më pas ndryshuam në këtë formë me një mesfushor organizator. Kjo skuadër mund të luaj edhe ndryshe, nuk është problem i skemës, por rëndësi ka të respektohen karakteristikat e lojtarëve. Mund të luajmë edhe kështu jo vetëm me 4-2-3-1, por edhe me 4-1-2-3.

Përfundon afati kalimtar në basketboll

PRISHTINË, 26 GUSHT - Ka përfunduar afati kalimtar në basketbollin e Kosovës në të dyja konkurrencat. Klubet kanë qenë mjaft aktive në këtë afat, duke u përforduar

varësisht nga synimet që kanë. Të gjitha klubet e elitës së basketbollit të meshkujve janë përforduar me lojtarë vendorë dhe ndërkombëtare. Mjaft aktive kanë qenë edhe

ato të Ligës së Parë të meshkujve. Gjithashtu edhe te Superliga Femrat, gjashtë skuadrat kanë bërë përfordimet e nevojshme, si dhe disa duke vazhduar me

lojtarët kryesore nga edicioni i kaluar. Gara pritet të jetë mjaft interesante në këtë edicion te femrat, duke marrë parasysh përfordimet e bërë.




Verstappen i zhgënjyer nga gara në Holandë: Situatë jo e mirë, por nuk ka vend për panik

Amsterdam, 26 gusht - Gara e fundit e Formula 1 në Holandë ishte një zhgënjim për pilotin vendës Max Verstappen, që u "mjaftua" me vendin e dytë. Por problem më i madh ishte se ai e mbylli garën 20 sekonda pas Lando Norris me McLaren. Kjo diferencë kaq e madhe nuk i pëlqen

Verstappenit, që ka ende 70 pikë avantazh ndaj britanikut në klasifikimin e përgjithshëm. "Unë mendoj se kjo ishte thjesht një fundjavë e keqe në përgjithësi", u shpreh Verstappen. "Nuk më pëlqen kjo diferencën me Norris, ndaj duhet të kuptojmë pse. Garat e fundit nuk kanë qenë

fantastike. Kjo situatë është paksa alarmante, por ne e dimë se nuk duhet të kemi panik", tha më tej 3 herë kampioni i botës. "Ne duhet të përqijemi të përmirësojmë situatën. Dhe kjo është ajo për të cilën ne po punojmë edhe pse Formula 1 është shumë e komplikuar", ka thënë më tej

holandezi i Red Bull Racing, që nuk fiton prej 5 garash. Verstappen shpreson të rigjejë fitoren në pistën e Monza, ku dhe ka disa risi: "Në Monza do të ketë asfalt të ri, bordura të reja dhe gjithashtu një modifikim në kthesën e parë të dyfishtë. E dimë që kemi shumë punë për të bërë".



Ademi: Nuk e planifikojmë 'Final Four'-in në Superligë

PRISHTINË, 26 GUSHT - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi ka dal kundër idesë që në Superligën e Kosovës në futboll të aplikohet edhe sistemi i 'Final Four' për titullin e kampion, një sistem që po aplikohet në shumë vende, madje së fundit edhe në Shqipëri. Ademi ka thënë se një gjë e tillë nuk është në planet e tij për momentin dhe kjo për shkak se në Kosovë mungon infrastruktura e duhur e stadiumeve. "Nuk e mendoj ta bëjë atë në ligën e Kosovës për momentin sepse ne së pari nuk e kemi infrastrukturën e nevojshme, nuk i kemi stadiumet e tilla. 'Final Four' bëhet për t'i pasur disa ndeshje më interesante dhe thjeshtë kjo është bërë për përfitim të të drejtave televizive dhe për bileta për klubet për të pasur shikueshmëri dhe profit më të mirë. Unë nuk



konsideroj që në Kosovë mund ta kemi atë për faktin që nuk kemi stadiumet të tilla ose nuk e kemi një çmim të biletës. Shqipëria e ka bërë promocion dhe nuk është që nuk bëhet, mund ta bëjmë shumë lehtë, por realisht

nuk e mendoj njëherë ta bëjë derisa të kryhet infrastruktura", ka thënë Ademi. Ndryshe, Superliga e Kosovës në futboll, edicioni 2024-25 ka nisur dhe tashmë janë zhvilluar dy xhiro të tij.

Ndërron jetë ish-trajneri i Anglisë, Sven-Goran Eriksson

Londër, 26 gusht - Ka vdekur në moshën 76-vjeçare, trajneri suedez Sven Goran Eriksson. Shtatë muaj më parë ai zbuloi për publikun se vuante nga kanceri i pankreasit dhe se i kishte mbetur maksimumi një vit jetë. Që atëherë, Eriksson u përpoq të kalonte sa më shumë kohë me familjen e tij dhe të përmbushte dëshirat e tij që nuk kishte mundur t'i arrinte më parë. Një prej tyre është edhe për t'u bërë trajner i Liverpoolit. Reds plotësuan dëshirën e tij dhe këtë pranverë ai drejtoi legjendat e tyre kundër legjendave të Ajax në Anfield. Eriksson vendosi të shfaqej muajt e fundit në një dokumentar në Amazon Prime. Disa pjesë të tij kanë rrjedhur, dhe ato përfshijnë Eriksson, i cili kalon pothuajse të gjithë kohën në Sunne, vendlindja e tij në Suedi, ku u bashkua me djalin dhe vajzën e tij. "Unë nuk isha



babai më i mirë, por tani kalojmë shumë kohë bashkë", thotë Eriksson, i cili shihet në video duke shijuar aktivitete të thjeshta me djalin e tij Johan dhe vajzën Lina. Eriksson depërtoi në Gothenburg, me të cilin fitoi dy Kupa të Suedisë, por një

triumf i bujshëm në Kupën UEFA në 1982 i dha atij një përparim në skenën e madhe. Ai mori Benfikën dhe në dy periudha fitoi tri kampionate dhe një kupë, dhe arriti në finalen e Kupës UEFA në 1983 dhe Kupën e Kampionëve në 1990. Ai la një gjurmë të madhe në Itali. Ka fituar kupën me Romën, Sampdoria dhe Lazio. Me këtë të fundit ia doli dy herë dhe një herë me Lazio mori edhe titullin. Të njëjtin klub e çoi gjithashtu në fitimin e Kupës së Fituesve të Kupave, në edicionin e fundit (1999). Lazio kaloi edhe në finalen e Kupës UEFA. Më pas, nga viti 2001 deri në vitin 2006, ai drejtoi një nga gjeneratat më të forta të Anglisë në histori, por nuk arriti të përparojë përtej çerekfinaleve të garave të mëdha. Gjatë gjashtë viteve të fundit të karrierës së tij, deri në vitin 2019, ai punoi në Kinë dhe Filipine.

SHKURT

Vitor Roque largohet nga Barça, huazohet te Betisi

Vitor Roque është larguar nga Barcelona për të nënshkruar me Real Betis në formë huazimi. Huazimi i Roque në Betis do të zgjasë një vit me një opsion për një vit tjetër. Nëse Roque qëndron në Betis për dy vjet, ata do të kenë një përqindje të pronësisë së lojtarit. Kështu, edhe nëse ai kthehet te Barcelona, Betis do të marrë një pjesë të çdo tarife të ardhshme të transferimit që skuadra katalunase merr për shitjen e lojtarit. Barcelona nënshkroi Roquen verën e kaluar në një marrëveshje me vlerë 30 milionë euro. 19-vjeçari luajti vetëm 16 ndeshje për klubin duke shënuar dy herë.

Dybala tregon pse refuzoi transferimin në Arabi

Futbollisti i Romës, Paulo Dybala, ka folur për herë të parë pasi refuzoi transferimin në Arabi. Argjentinasin në momentin e fundit u tërhoq nga marrëveshja me Al Qadsiah ku parashihej t'i fitonte 75 milionë euro për tre vjet. "E kam marrë parasysh familjen time, gruan time, qytetin, ekipin, kombëtaren...njerëzit flasin për para por kam marrë në konsideratë shumë faktorë. Jam 30-vjeçar, i kam konsideruar të gjithë faktorët dhe jam shumë i lumtur që po rri", ka thënë Dybala.

Nico Gonzalez prezantohet nga Juventus

Juventus ka konfirmuar transferimin e Nico Gonzalez. Sulmuesi anësor i bashkohet Juventusit nga Fiorentina, pas disa sezonesh të mira me këtë klub. Dy klubet arritën marrëveshje për një shifër prej 38 milionë eurosh, përfshirë edhe bonuset. Duke hyrë në detaje, marrëveshja është strukturuar si më poshtë: 8 milionë euro kushton huazimi, 25 milionë euro detyrimi për blerje dhe 5 milionë euro të tjera për bonuse. Gonzalez luajti te Stuttgarti para se të kalonte në Itali, ku me klubin gjerman ai bëri 79 paraqitje në tre sezone, duke u dëshmuar si një lojtar i vlefshëm, me 23 gola dhe 10 asistime. Me klubin nga Firenca ai ka 125 ndeshje të luajtura, ku shënoi 38 gola dhe dhuroi 19 asistime. Ai është pjesë e Argjentinës së Lionel Scaloni dhe së fundmi triumfoi të Copa America.

Kompany shijon fitoren e parë: Nuk ishim perfekt, por shohim përpara

Bayern Munchen e nis me fitore sezonin e ri në Bundesliga. Vincent Kompany arrin suksesin e parë si trajner i bavarezëve, në sfidën përballë "ujqërve" të Wolfsburg. "E shijova, ishte fitorja ime e parë si trajner në Bundesliga. Në pjesën e parë dominuam, por për shkak të gabimeve u ndëshkuam me dy gola me fillimin e pjesës së dytë. Gabimet ndodhin e rëndësishme është që skuadra të reagojë. Patëm kurajon të fitonim ndeshjen në fund. Nuk ishim perfekt, por vijojmë të shohim përpara", ka thënë Kompany.

Djali i LeBron siguron marrëveshjen me Lakersat

Një ëndërr e dyfishtë u realizua. LeBron James do të luajë në krah të të birit në basketbollin amerikan, pasi Bronny James u zgjodh për të qenë pjesë e NBA-s, me 19-vjeçarin, që do të veshë fanellën e Los Angeles Lakers, njërit prej dy klubeve më të

mëdhenj në rruzull, e do të jetë bashkë me të atin. Një kontrast i madh ky, pasi mes dy basketbollistëve që i përkasin të njëjtës familje ka një diferencë moshe 20-vjeçare, me "Mbretin", LeBron James, i cili është 39 vjeç, e në dhjetor të këtij viti mbush 40,

teksa mund të konsiderohet edhe si legjenda e madhe dhe e gjallë e basketbollit amerikan dhe atij botëror. Në 20 vjet karrierë, ka fituar 4 tituj, ka thyer rekordin e pikëve dhe është lojtar i më i kompletuar në histori, në të gjithë elementët si pikët, topat në tabela

e asistet. Nuk dihet nëse do të cilësohet më i madh sesa Michael Jordan, i barabartë apo pak më poshtë se ai, gjithsesi, dëshira e tij e madhe vitet e fundit ishte të vazhdonte aq sa të luante me të birin. Sidoqoftë, nuk dihet nëse kjo dyshe, "babë e bir" do të ketë

sukses në parket. Nëse si biznes është i shkëlqyer, Bronny James ka marrë kritika për nivelin e tij të basketbollit, madje këto janë shtuar kohët e fundit e për më tepër, ai pati edhe operacion në zemër, ndërsa vazhdonte në basketbollin e kolegjeve.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Mbikëqyrës i lartë i Sigurimeve (një pozitë)
Grada e pozitës:	Pesë (5)
Pozita:	E përhershme
Departamenti:	Departamenti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve
Divizioni:	Divizioni i Mbikëqyrjes në Vend
I raporton:	Udhëheqësit të Mbikëqyrjes në Vend

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësie:

- Kryen ekzaminime të vazhdueshme të kompanive të sigurimeve dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve;
- Udhëheq ekipën e ekzaminerëve në ekzaminimet në vend të siguruesve/ trajtuesve të dëmeve dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve;
- Bën planifikimin para ekzaminimit, duke përfshirë fushëveprimin e ekzaminimit dhe profilin e rrezikut të kompanisë;
- Kryen ekzaminime të fokusuara, për të adresuar fushat me probleme specifike;
- Kryen ekzaminimet para ekzaminimit të rishikon raportet që dalin nga divizioni për raportim dhe analiza për nga saktësia, cilësia dhe përmbajtja e tyre;
- Kryen aktivitetet pas ekzaminimit duke përfshirë përpilimin e raportit të ekzaminimit me klasifikimet eaktuara të rrezikut dhe strategjitë mbikëqyrëse;
- Përpilon rekomandimet për masat që duhet të ndërmerren, bazuar në rezultatet e ekzaminimit;
- Rishikon raportet e ekzaminimit në terren për nga saktësia e ekzaminimit të realizuar, cilësia dhe përmbajtja e raportit.
- Bën përpilimin e letrës përcjellëse të raportit të ekzaminimit;
- Zhvillimin e masave përmirësuese – memorandumëve të mirëkuptimit, marrëveshjeve, urdhrave duke përfshirë largimet dhe suspendimet etj.;
- Bën përcjelljen e zbatimit të masave përmirësuese;
- Ndihmon Udhëheqësin e divizionit të mbikëqyrjes në vend/ Drejtorin e mbikëqyrjes së sigurimeve në takime me siguruesit, apo të tjerë;
- Udhëzon dhe trajnon mbikëqyrësit e sigurimeve që ka nën varësi, ashtu si udhëzohet nga Udhëheqësit i Divizionit të Mbikëqyrjes në Vend/ Drejtori i Departamentit të Sigurimeve;
- Kontribuon në planet e zhvillimit individual për inspektorët e sigurimeve dhe inspektorët fillestarë/juniorë të sigurimeve dhe certifikon përfundimin e planit të zhvillimit individual;
- Asiston në vlerësimin e performancës për mbikëqyrësit e sigurimeve dhe mbikëqyrësit e ri të sigurimeve;
- Rishikon/përpilon rregullat dhe rregulloret e reja të propozuara dhe identifikon çështjet/ndikimin;
- Ndjek zhvillimet në fushën e sigurimeve në nivel ndërkombëtar dhe bën propozime për ndryshime në kornizën ligjore të punës, në mënyrë që të rritet efikasiteti i mbikëqyrjes. (IAIS, IFRS 17, Solvenca I dhe II) etj.;
- Rekomandon ndryshime në procedurat/politikat e ekzaminimit;
- Siguron informata për raportin javor të mbikëqyrjes;
- Përmbush detyra të tjera të cilat i caktohen nga Udhëheqësi i Divizionit të Mbikëqyrjes në Vend/ Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve;

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Diplomë universitare në ekonomi, kontabilitet, financa, menaxhim, biznes, informatikë, matematikë;
- Të ketë përvojë pune profesionale në minimum 3 vite në fushën e menaxhimit të rreziqeve, auditim, financa, kontabilitet ose fusha të tjera të ngjashme që nder-lidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve;
- Përvoja në sigurime ose institucione të tjera financiare paraqet përparësi;
- Preferohen diploma dhe certifikata mbi përfundimin e kurseve dhe specializimeve të ndryshme në fushën e kontabilitetit (kontabilist i certifikuar), auditimit (auditor i jashtëm i certifikuar), certifikime në fushën e sigurimeve dhe rreziqeve;
- Aftësi të thella analitike në funksion të vlerësimit të rreziqeve dhe shëndetit të institucioneve financiare të mbikëqyrura;
- Njohuri domethënëse të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF) në funksion të vlerësimit të cilësisë së raportimit financiar dhe analizimit të pasqyrave financiare për qëllime mbikëqyrëse;
- Njohuri domethënëse të kornizës ligjore dhe rregullative, si dhe standardet e tjera të zbatueshme ndaj siguruesve, trajtuesve të dëmeve dhe ndërmjetësuesve për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre;
- Kërkoheft aftësi e shquar e të kuptuarit dhe zbatimit të proceduarve dhe manualit të bazuar në rrezik gjatë ekzaminimit të institucioneve financiare;
- Përdor gjykim të drejtë dhe të logjikshëm për të realizuar praktika, objektiva dhe vendime të pavarura;
- Kërkoheft të demonstroj aftësi domethënëse të komunikimit verbal, komunikimit me shkrim, hartimit të raporteve dhe prezantimit tek mbikëqyrësi, ekipi i ekzaminimit dhe palët e tjera;
- Aftësi shumë e madhe për të punuar në mënyrë efektive në grup me ekipin e ekzaminerëve; aftësi për menaxhimin e kohës lidhur me përfundimin cilësor të detyrave të deleguara;
- Njohje e mirë e Ms. Office;
- Preferohet të ketë njohje të mirë të gjuhës angleze;

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **10 shtator 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Naziv radnog mesta:	Viši supervizor osiguranja (jedna pozicija)
Stepen pozicije:	Pet (5)
Pozicija:	Na neodređeno
Odeljenje:	Odeljenje za nadzor osiguranja
Odsek:	Odsek za nadzor na licu mesta
Izveštava:	Rukovodiocu nadzora na licu mesta

Pregled dužnosti i odgovornosti:

- Sprovodi stalne kontrole osiguravajućih društava i posrednika osiguranja;
- Vodi tim kontrolora u kontrolama na licu mesta osiguravača/rukovaoca štetama i posrednika osiguranja;
- Sprovodi planiranje pre kontrola, uključujući delokrug kontrola i profil rizika kompanije;
- Sprovodi fokusirane kontrole za rešavanje oblasti sa specifičnim problemima;
- Vrši kontrole na licu mesta i pregleda izveštaje koje izdaje odsek za izveštavanje i analizu za njihovu tačnost, kvalitet i sadržaj;
- Obavlja aktivnosti nakon kontrole uključujući pripremu izveštaja o kontroli sa zadatim klasifikacijama rizika i nadzornim strategijama;
- Sastavlja preporuke za mere koje treba preduzeti, na osnovu rezultata kontrole;
- Pregledava izveštaje o terenskim kontrolama u pogledu tačnosti obavljene kontrole, kvaliteta i sadržaja izveštaja.
- Sastavlja propratno pismo izveštaja o kontroli;
- Vrši izradu korektivnih mera – memorandumi o razumevanju, sporazumi, nalozi uključujući smene i suspenzije, itd.;
- Prati sprovođenje korektivnih mera;
- Pomaže rukovodiocu Odseka za nadzor na licu mesta/direktoru nadzora osiguranja na sastancima sa osiguravačima ili drugima;
- Vodi i obučava supervizore osiguranja iz svoje nadležnosti, prema instrukcijama rukovodioca Odseka za nadzor na licu mesta/direktora Odeljenja za osiguranje;
- Doprinosi individualnim razvojnim planovima za inspektore osiguranja i mlađe inspektore osiguranja i potvrđuje završetak individualnog razvojnog plana;
- Pomaže u proceni rada za supervizore osiguranja i mlađe supervizore osiguranja;
- Pregleda/sastavlja nova predložena pravila i uredbe i identifikuje probleme/uticaj;
- Prati dešavanja u oblasti osiguranja na međunarodnom nivou i daje predloge za izmene zakonskog okvira rada, u cilju povećanja efikasnosti nadzora. (IAIS, MSFI 17, Solventnost I i II) itd.;
- Predlaže promene u procedurama/politikama kontrole;
- Pruž a informacije za nedeljni izveštaj o nadzoru;
- Obavlja i druge poslove po nalogu rukovodioca Odseka za nadzor na licu mesta/direktora Odeljenja za nadzor osiguranja;

Potrebne kvalifikacije i iskustvo:

- Univerzitetska diploma ekonomije, računovodstva, finansija, menadžmenta, poslovanja, informatike, matematike;
- Da ima najmanje 3 godine profesionalnog radnog iskustva u oblasti upravljanja rizicima, revizije, finansija, računovodstva ili drugih sličnih oblasti koje se odnose na poslove i odgovornosti Odeljenja za nadzor osiguranja;
- Iskustvo u osiguranju ili drugim finansijskim institucijama je prednost;
- Poželjne su diplome i sertifikati o završenim različitim kursovima i specijalizacijama iz oblasti računovodstva (sertifikovani računovođa), revizije (sertifikovani eksterni revizor), sertifikati iz oblasti osiguranja i rizika;
- Duboke analitičke veštine u cilju procene rizika i zdravlja nadziranih finansijskih institucija;
- Suštinско poznavanje međunarodnih standarda finansijskog izveštavanja (MSFI) u cilju procene kvaliteta finansijskog izveštavanja i analize finansijskih izveštaja za nadzorne svrhe;
- Suštinско poznavanje pravnog i regulatornog okvira i drugih standarda koji se primenjuju na osiguravače, rukovaoce štete i posrednike za procenu njihove usklađenosti;
- Potrebna je izvanredna sposobnost razumevanja i primene procedura i priručnika zasnovanih na riziku prilikom kontrola finansijskih institucija;
- Koristi pravedno i logično prosuđivanje za realizaciju praksi, ciljeva i nezavisnih odluka;
- Potrebno je demonstriranje značajne verbalne komunikacije, pismene komunikacije, pisanja izveštaja i veština prezentacije supervizoru, kontrolnom timu i drugim stranama;
- Veoma jaka sposobnost za efikasan rad u grupi sa timom kontrolora; veštine upravljanja vremenom koje se odnose na kvalitativno izvršavanje delegiranih zadataka;
- Dobro poznavanje Ms. Office;
- Dobro poznavanje engleskog jezika je poželjno;

Svi kandidati moraju da dostave sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem se ističe interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde od poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje pozicije koju ste imali i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata o zaštiti podataka o ličnosti);
- Izveštaj Fonda penziona štednje Kosova (Trust)** za relevantni period, ili poresku potvrdu Poreske administracije (PAK) kada se izveštaj Trusta ne primenjuje zakonski;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak prijave:

- Zadnji rok za podnošenje prijava je **10 septembar 2024**.
- Prijava se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi oblik prijave neće biti razmatran.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti putem službene veb stranice: www.bqk-kos.org

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Bessko Camera” SH.P.K. me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812101327 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Bessko Camera” D.O.O. Vushtrri, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812101327 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Bessko Camera” L.L.C. with headquarters Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 812101327 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Hausmeister 2022” SH.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811966946 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Hausmeister 2022” D.O.O. Mitrovicë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811966946 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Hausmeister 2022” L.L.C. with headquarters Mitrovicë, has come to the decision to quit its business: 811966946 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjei PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjei Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT



SWISS

TAVERNA



Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Njoftojmë të gjithë klientët se exCash L.L.C. me seli në Kamenicë, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara me nrb: 812083723, bënë zvogëlimin e kapitalit nga 30.000 në 15.000.
- Astrit Xhemaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “Fadil Hisari” Prizren.
- Saranda Krasniqi shpall te pavlefshme certifikatën e testit maturës QK “11 Marsi” Prizren.
- Avdullah Krasniqi nga Ratkoci shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Antoneta Margegaj nga Dol shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f. Anton Çeta KK Gjakovë, nga kl. 1-8.
- Mend Ukaj shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X të shkollës së mesme “Hjadar Dushi” Gjakovë.
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçant me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Hanife Berisha shpall të pavlefshme dëftesën e vitit të 1, 2 të Gjimnazit “Sami Frashëri” Prishtinë.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Sabrije Loshaj Gorqaj nga Gjakova shpall të pavlefshme librezën e punës të lëshuar nga tekstili “Emin Duraku.
- Visar Hajdari shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme “Shtjefën Gjeqovi” Prishtinë.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Alban Ferizi shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Dr. Ali Sokoli” Prishtinë.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Redon Morina shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu “Abdyl Frasheri” Prizren.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





TRADITË QË NGA 1992

